



- b) kopjen e njësuar me origjinalin të librezës së punës;
- c) kopjen e dokumentit të identitetit (ID);
- d) tabelën me të dhënat për aplikantin (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi);
- e) certifikatën e drejtuesit të IPAP ose vërtetimin nga shkolla e Drejtorëve që është pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor.
- f) vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi);
- g) vërtetim nga institucioni ku punon, që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- h) deklaratën e konfliktit të interesit me punonjësit arsimorë të IPAP (bashkëshort/bashkëshorte, prind, vëlla/motër, fëmijë në moshë madhore, prindër të bashkëshortit/bashkëshortes), sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

**Drejtori aktual i IPAP ose zëvendësuesi i tij vë në dispozicion të secilit aplikant një kopje të dokumenteve të mëposhtme:**

- a) planin afatmesëm të shkollës;
- b) planin vjetor të shkollës të vitit paraardhës;
- c) raportin vjetor të shkollës të vitit paraardhës

Dokumentacioni i aplikimit, i përcaktuar në pikën 2 ,të shkronjës B, dorëzohet nëpërmjet shërbimit postar në ZVAP-in përkatës jo më vonë se **10 dite nga data e shpalljes**.

**2. Data e shpalljes së rezultateve të verifikimit paraprak të dokumentacionit.**

Rezultatet e verifikimit paraprak të dokumentacionit do të shpallen jo më vonë se data **02.09.2022**. Aplikantët me mungesa në dokumentacion do të njoftohen nëpërmjet e-mailit për plotësimin e dokumentacionit brenda 3 ditë pune nga data e njoftimit të verifikimit paraprak.

**3. Pas vlerësimit të dosjeve aplikantët me dokumentacionin e plotë dhe të saktë do të kryejnë intervistën e strukturuar për:**

Fusha e njohurive dhe aftësitë në drejtimin e institucionit mbi të cilat do të zhvillohet intervista e strukturuar:

- a) Ligji 69/2012 “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,
- b) Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2021-2026.